NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 12 nëntor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

- **Licencimi dhe ndryshimi i vendimeve**

Në ushtrim të kompetencave të tij rregullatore, Bordi vendosi:

-Fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Vitol Albania Gas and Power" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- "INFO-TELECOM ALBSOLAR 4" sh.p.k. – Bordi i ERE-s miratoi ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 287, datë 13.11.2025, për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke përcaktuar se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2028.

-"BMG ENERGY SAL" sh.p.k. – Bordi i ERE-s miratoi ndryshimin e pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 175, datë 29.08.2024, duke përcaktuar datën 31.03.2027 si afatin për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria.

Regjistrohen katër impiante të reja të depozitimit të energjisë elektrike

Në vijim të zbatimit të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 59/2026, Bordi i ERE-s miratoi regjistrimin e katër impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruara nga shoqëritë "POWER ENERGY" sh.p.k., "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k., "EU GREEN ENERGY" sh.p.k. dhe "GSA" sh.p.k.

Impiantet e regjistruara kanë këto karakteristika:

-"POWER ENERGY" sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 25 MW dhe kapacitet depozitimi 100 MWh.

-"NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 130 MW dhe kapacitet depozitimi 260 MWh.

-"EU GREEN ENERGY" sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 100 MW dhe kapacitet depozitimi 400 MWh.

-"GSA" sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 15 MW dhe kapacitet depozitimi 30 MWh.

Regjistrimi është kryer në kuadër të licencave ekzistuese të prodhimit ose tregtimit të energjisë elektrike, sipas regjimit kalimtar të parashikuar në ligjin nr. 59/2026.

Për këto impiante lejohet operimi gjatë periudhës kalimtare, deri në 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, me detyrimin për aplikimin për licencën përkatëse për vijimin e aktivitetit përtej këtij afati.

Në vijim të çështjeve të trajtuara, Bordi i ERE-s u njoh me raportimin e garancive të origjinës për periudhën tetor 2026, si dhe me të dhënat e paraqitura në kuadër të këtij procesi. Gjithashtu, u diskutuan praktikat e ndjekura për regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, duke u ndalur në procedurat përkatëse, shqyrtimin e aplikimeve të paraqitura nga subjektet dhe dokumentacionin teknik e financiar shoqërues.

Në përmbyllje, Bordi u njoh me informacionin mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Masave për përmbushjen e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për ERE-n gjatë vitit 2026, si dhe me ecurinë e punës së dy Grupeve të Punës të ngritura për hartimin dhe përshtatjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", në fushën e licencimit dhe ushtrimit të veprimtarive të rregulluara, si dhe në atë të mbrojtjes së konsumatorëve, klientëve aktivë dhe komuniteteve të energjisë. Në këtë kuadër, Bordi u informua mbi aktet rregullatore të përfunduara dhe të miratuara, projektaktet për të cilat kanë nisur procedurat administrative, si dhe aktet që janë në proces hartimi, të cilat synojnë përshtatjen e kuadrit rregullator me kërkesat e ligjit të ri, forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve dhe përcaktimin e rregullave dhe procedurave për ushtrimin e veprimtarive të reja në sektorin e energjisë elektrike.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.